



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 108, të vitit 2024, në ngarkim të të pandehurve **Gëzim Bakalli** (alias **Shkembim Cërmanji**) dhe **Erjon Loci**”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjyimit të shkurtuar. Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Erjon Çela, Flora Hajredinaj dhe Rudina Palloj, me vendimin nr. **11**, datë **10.02.2026** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Gëzim Bakalli** (alias **Shkembim Cërmanji**) për kryerjen e veprës penale "*Trafikim i narkotikëve*", kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, dhe më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 283/a/2 – 28/4 të K.Penal, dhe në lidhje me nenin 334/1 të K.Penal "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal*", dënimin e tij me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim.
- 2.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Gëzim Bakalli** (alias **Shkembim Cërmanji**), për kryerjen e veprës penale "*Grup i strukturuar kriminal*", kryer në formën e drejtimit, parashikuar nga neni 333/a/1 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim.
- 3.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Gëzim Bakalli** (alias **Shkembim Cërmanji**), për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i dokumenteve*", e parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
- 4.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Gëzim Bakalli** (alias **Shkembim Cërmanji**), për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave*", e parashikuar nga neni 189/1 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
- 5.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Gëzim Bakalli** (alias **Shkembim Cërmanji**), për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i akteve të gjendjes civile*", e parashikuar nga neni 191/1 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
- 6.** Në zbatim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e disa veprave penale, i pandehuri **Gëzim Bakalli** (alias **Shkembim Cërmanji**) dënohet me një dënim të vetëm prej

- 19 (nëntëmbëdhjetë) vjet burgim.
7. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Gëzim Bakalli (*alias Shkembim Cërmanji*) me një dënim të vetëm prej 12 (dymbëdhjetë) vjet dhe 8 (tetë) muaj burgim.
 8. Vuajta e dënimit për të pandehurin Gëzim Bakalli (*alias Shkembim Cërmanji*) të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së lartë.
 9. Deklarimin fajtor **të të pandehurit Erjon Loci** për kryerjen e veprës penale "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*", kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, dhe më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 28/4 të K.Penal, në lidhje me nenin 334/1 të K.Penal "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal*", dhe dënimin e tij me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim.
 10. Deklarimin fajtor të të pandehurit Erjon Loci për kryerjen e veprës penale "*Grup i strukturuar kriminal*", kryer në formën e pjesëmarrjes, parashikuar nga neni 333/a/2 i K.Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
 11. Në zbatim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e dy veprave penale, i pandehuri Erjon Loci dënohet me një dënim të vetëm prej 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim.
 12. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Erjon Loci me një dënim të vetëm prej 8 (tetë) vjet burgim.
 13. Vuajta e dënimit për të pandehurin Erjon Loci të fillojë nga dita e arrestimit të tij dhe të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së lartë.
 14. Në lidhje me provat materiale të sekuestruara për llogari të procedimit penal në zbatim të nenit 190 të K.Pr.Penale të procedohet si më poshtë:
 - Dokument në disa gjuhë i shtetit zviceran; Pasaportë në gjuhë italiane me numër **** në emër të shtetases P.R; Pasaportë në gjuhë italiane me numër **** në emër të shtetasit A.A; Një palë syze të markës GUCCI ngjyrë e zezë e verdhë; Një varëse me ngjyrë të verdhë si ajo e floririt me një medalion; Një orë dore femrash e markës Hublot MD Geneve me numër serial **** në kuti me mbishkrimin Rolex sekuestruar në banesën e të pandehurit Gëzim Bakalli; Një telefon iPhone ngjyrë bezhë dhe flori model ****, IMEI ****, Një telefon iPhone 8 i bardhë, të sekuestruara të pandehurit Erjon Loci; Laptop MacBook Pro model ****, FCC ID: ****, IC: ****, ****, Serial number **** (Sektori ekspertizës), të qëndrojnë në fashikullin e hetimit të procedimit të ndarë nr. 108/1 të vitit 2025.
 - Dokumentet lejë drejtimi automjeti/patentë kosovare me nr. ****, e datës 13/1/2023; pasaportë kosovare me numër ****, e datës 27/2/2023, me vlefshmëri deri më datë 26.2.2033; kartë identiteti/Letërnjoftim i kosovës me numër ****, i datës 3/11/2022 për të cilat gjatë gjykimit rezultoi se janë të falsifikuara të asgjësohen.
 15. Shpenzimet procedurale gjatë fazës së hetimit në shumën 43,630 lekë (dyzet e tremijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë si dhe shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim të pandehurve

në mënyrë solidare.

- 16.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga palët brënda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datë 10.02.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar